

Jetonte në Smrekonicë/Smrekovnica, me bashkëshorten e tij Sylemen, djemtë Nexhatin dhe Nexhmiun, te rejat dhe nipin. Në datën **17.09.1998**, rreth orës 7:00 të mëngjesit, familja e Halilit dhe banorët e tjerë u strehuan në fshatin Kqiq i Madh/Veliki Kičić [Mitrovicë/Kosovska Mitrovica]. Pëshpërtejt se forcat serbe po i afroreshin fshatit. Halili qëndroi në fshat me vëllezërit Hajzerin dhe Habibin dhe disa burra të tjerë. Pas një kohe të shkurtër, fshati u bombardua, kështu që burrat u strehuan në shtëpinë e Jahir Mustafës, ndërsa Halili shkoi në drejtim të vëllait Habibit. Të nesërmen, meshkujt e kishin gjetur trupin e pajetë të Halilit në pyll, pas shtëpisë së tij [**Smrekonicë/Smrekovnica**]. E kishin qëlluar me 18 plumba. Po atë ditë, u varros në varrezat e fshatit. Një banor i fshatit fqinj i kishte treguar familjes së Halilit se, më datë 17.09.1998, me dylbi kishte shikuar se si Halili ishte nisur nga shtëpia në drejtim të pyllit, por me të parë ushtarët serb, Halili tentoi që të kthehej. Ushtarët serb kishin shtënë në drejtim të tij. Kur Halili ra në tokë, pesë ushtarë, pasi që ishin afruar, përsëri kishin shtënë mbi të, ndërsa më pas ia kishin marr kuletën nga setra.

Burimet: deklarata H.M, FDH-19578; *Serb Troops Kill Albanian in His Home in Vushtrri*, pasqyra e lajmeve, KIC, 18.09.1998, FDH-29565; *LDK Activist, Shot and Wounded by Serb Forces, Dies*, pasqyra e lajmeve, KIC, 21.09.1998, FDH-29567.

Faton (Fazli) Syla

(8.07.1983, shqiptar nga Bençuku/Benčuk, komuna e Vushtrrisë/Vučitrn, nxënës)

Fatoni jetonte me prindërit Fazliun dhe Bahtien, të vëllain Ferkiun dhe familjen e tij. Në datën **22.09.1998**, rreth orës 7:00 të mëngjesit, Fatoni përgatitej që të nisej në shkollë. Në ato çaste forcat serbe filluan granatimin e fshatit, kështu që Fatoni me familje u strehuan në pyllin e afërt. U ndaluan në vendin e quajtur *Gurët e Shabanit/Shabanove stene* [**Bečuk/Benčuk**], ku u strehuan edhe banorët e tjerë të fshatit. Në çastin kur Fatoni qëndronte pranë një traktori, në afërsi të tij

ra një granatë. Një cifël e granatës Fatonin e qëllloi në kokë, afër syrit të majtë. Ai ndërroi jetë 15 minuta më vonë. Prindërit dhe i vëllai e varrosën Fatonin në pyll. Tri ditë më pas, familja e tij u kthye në fshat. Në datën 29.09.1998, e rivarrosën Fatonin në varrezat e fshatit

Burimet: deklarata F.S, FDH-18749; *Serb Forces Continue Burning Vushtrri Villages*, pasqyra e lajmeve, KIC, 24.09.1998, FDH-29570; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.P01434, FDH-33273.

Hajrullah (Halil) Gjaka

(1932, shqiptar nga Oshlani/Ošljane, komuna e Vushtrrisë/Vučitrn, bujk, tetë fëmijë)

Hajrullahu i moshuar ishte gati i palëvizshëm. I përdorte paterica për të ecur. Familja e tij e braktisi fshatin Oshlan/Ošljane më 29.09.1998, kur u dëgjua se forcat serbe po i afroreshin fshatit. I biri i tij Rasimi kishte shikuar me ushtarët e UÇK-së në pyll. Dy ditë më vonë, më **22.09.1998**, Rasimi u kthye për ta marr babanë, por ai kishte vendosur të qëndronte në shtëpi. Ai e kishte një bombë, për të cilën Rasimi nuk e dinte ku e kishte marr. Po atë ditë, forcat serbe kishin hyrë në fshat. Pasi që kishin hyrë policët në oborrin e Hajrullahut, ai e aktivizoi bombën, duke vrrarë vetën dhe një polic [të shikohet regjistrim në vijim]. Gjatë natës, Rasimi me dajën Kamber Imerin u kthyen në fshat. Në oborrin e shtëpisë i gjetën mbetjet mortore të Hajrullahut, ndërsa në pyllin e **Oshlanit/Ošljane**, trupin e të birit Kamberit [të shikohet regjistrimi në vijim]. Ata u varrosën më 26.09.1998, në pyllin e fshatit Oshlan/Ošljane, pas tërheqjes së forcave serbe. Pas lufte, në qershor të vitit 1999, mbetjet mortore të Hajrullahut janë rivarrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Oshlan/Ošljane. Patologët e Institutit për Mjekësi Ligjore në Rahovec/Orahovac, më 22.08.2000, i kanë zhvarrosur trupat e Hajrullahut dhe të tjerëve që kishin pësuar në Oshlan/Ošljane. Ata u rivarrosën në varrezat e njëjta më 27.09.2000.

Burimet: deklarata R.G, FDH-19403; *Serb Forces Continue Burning Vushtrri Villages*, pasqyra e lajmeve, KIC, 24.09.1998, FDH-